

BULETINI



MENAXHMENTI

i KOSTT priti në vizitë delegacionin e lartë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë

VLERËSOHET

performansa si dhe roli genësor i KOSTT në funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës

KOSOVA DHE

SHQIPËRIA

të vendosura për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike

NËNSHKRUHEN KONTRATAT PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I SISTEMIT TRANSMETUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS", BASHKËFINANCUAR ME BERZH

PËRMBAJTJA

Në 10 vite të operimit, KOSTT mbetet i përkushtuar në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në Sistemin Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës	3
Vlerësohet performansa si dhe roli qenësor i KOSTT në funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës	6
KOSTT nënshkruan marrëveshje me KEDS për shfrytëzimin e pronave me qëllim të implementimit të projekteve të transmisionit	7
Kosova dhe Shqipëria të vendosura për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike	8
U prezantua Raporti i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e Linjës së dyfishtë 110kV që lidhë NS 400/110kV Peja 3 me NS 110/35/10 kV Peja 1	9
Delegacioni i KOSTT në krye me Kryetaren e Bordit të Drejtorëve merr pjesë në Forumin e Vjenës për Energji	9
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Hasani merr pjesë në Forumin e Nivelit të Lartë "Siguria e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë"	10
Nënshkruhen kontratat për Projektin "Zhvillimi i Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Kosovës", bashkëfinancuar me BERZH	11
Inaugurohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri	12
Menaxhmenti i KOSTT priti në vizitë delegacionin e lartë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë	13
Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi vizitoi KOSTT-in	14
Menaxhmenti i KOSTT i përkushtuar në përmbushjen e Planeve Zhvillimore të Rrjetit Transmetues	14
Menaxhmenti i KOSTT inspektoi punimet që po zhvillohen në kuadër të projektit "Përmirësimi i Rrjetit Transmetues", faza IV dhe V	15
Të Dhënat e Transparencës	15
Kuvendi i Kosovës miraton ligjet e reja të energjisë	16
Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (gjatë periudhës shkurt-gusht 2016)	16

Buletini nr.12, Viti IX, 2016

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,

Rr. Isa Boletini nr.39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 301 174 ; email: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

NË 10 VITE TË OPERIMIT, KOSTT MBETET I PËRKUSHTUAR NË RUAJTJEN DHE KRIJIMIN E VLERAVE TË REJA NË SISTEMIN ELEKTROENERGJETIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Mustafë Hasani

Kryeshef Ekzekutiv

Kosova është shteti më i ri në Evropë i cili shtrihet në zemër të Ballkanit. Me një ekonomi e cila është në rritje, ku sipas Bankës Botërore në vitin 2015 Kosova ka shënuar rritje prej 3.6%, zhvillimi i sektorit të energjisë përbën një nga shtyllat kyçe në mbështetje të progresit ekonomik dhe mirëqenies sociale në vend.

I themeluar me 1 korrik 2006 KOSTT sh.a është kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore ku sipas Ligjit për energjinë elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. KOSTT funksionon në bazë të licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për Operimin e Sistemit të Transmisionit dhe Operimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë.

Fillet e zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturës së rrjetit transmetues të Kosovës datojnë që nga vitet e 50-ta të shekullit të kaluar kur u ndërtuan linjat e para të tensionit të lartë 110 kV për të vazhduar me

ndërtimin e linjave të nivelit 220 kV dhe 400 kV në vitet 60-ta përkatësisht 70-ta të shekullit XX.

Kur është themeluar KOSTT në vitin 2006, ka trashëguar një rrjet të vjetër, i cili me vështirësi të mëdha ka menaxhuar rrjedhat e energjisë elektrike nëpër rrjetin e transmisionit. Përkundër sfidave të shumta, 10 vite pas, KOSTT ka shënuar progres në të gjitha aspektet e veprimtarisë së vet, duke krijuar kështu vlerë për aksionarin dhe qytetarët e Kosovës.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmisionit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV.

Aktualisht, Kosova ka 1324 km të linjave të transmisionit, të tensionit të lartë derisa për periudhën 10 vjeçare janë ndërtuar më se 267 km linja të reja.



KAPACITETET BARTËSE NGA 930 MW NË VITIN 2006, DERI NË FUND TË VITIT 2016 DO TË RRITEN PËR 83% (APO DO TË ARRIJNË NË 1700 MW). GJITHASHTU, FALË INVESTIMEVE TË VAZHUESHME HUMBJET NË RRJETIN E TRANSMISIONIT JANË ZVOGËLUAR PËR 58% QË NJËHERIT PËRBËJNË HUMBJET MË TË ULTA NË RAJON.

Rritja e vazhdueshme e konsumit të energjisë elektrike në vend dhe rajon, rritë flukset e fuqisë në linjat e brendshme dhe në ato të interkoneksionit. Një sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike vjetore që sillet rreth 35-40 % të konsumit nacional kalon tranzit përmes rrjetit horizontal të transmisionit të Kosovës.

Aktualisht KOSTT ka 59 autotransformatorë me kapacitete transformuese prej 5796 MVA të vendosur nëpër 36 Nënstacione në Kosovë. Komandimi dhe monitorimi i Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Kosovës realizohet nga Qendra Nacionale Dispečerike në KOSTT, e cila njëherit është një nga qendrat që operon me sistemin më të avancuar të monitorimit dhe komandimit në rajon.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për shfrytëzuesit e Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës KOSTT në pajtim me mandatin e saj dhe në përputhje me Planin Zhvillimor të Transmisionit duke i'u falënderuar edhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtar si KfW, EBRD, BE, USAID, BB vazhdon të jetë një hap përpara duke ruajtur dhe avancuar nivelin e gatishmërisë së Rrjetit Transmetues për të akomoduar kapacitetet e reja gjeneruese përfshirë

burimet e ripërtrishme të energjisë elektrike si dhe për të përkrahur zhvillimin e ngarkesës në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

INVESTIMET E REALIZUARA PËR PERIUHDHËN 2006-2015 KAPIN VLERËN PREJ 178 MILION EURO NDËRSA DERI NË VITIN 2018 JANË TË ZOTUARA INVESTIME NË VLERË PREJ 79 MILION EURO. PËRVEÇ INVESTIMEVE TË VAZHUESHME, BESUESHMËRIA E RRJETIT TË TRANSMISIONIT ËSHTË ARRITUR EDHE SI REZULTAT I MIRËMBAJTJES PREVENTIVE PËRMES SË CILËS JANË ELIMINUAR NGJARJET E PAPRITURA NË RRJETIN E TRANSMISIONIT.

KOSTT vazhdon që në mënyrë proaktive të punoj si në ngritjen e kapaciteteve të transmisionit ashtu edhe në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike të Kosovës duke kontribuar kështu në krijimin e kushteve për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe ngritjen e besueshmerisë së Sistemit të Transmisionit.

Nga përkushtimet primare të KOSTT përgjatë këtyre viteve të funksionimit ka qenë puna rreth organizimit dhe administrimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë për të krijuar kushte transparente dhe jodiskriminuese të tregtimit me energji elektrike ndërmjet palëve në treg mbështetur në Dizajnin e Tregut të energjisë elektrike si dhe Rregullat e Tregut.

Në kuadër të zhvillimit të mëtutjeshëm të tregut të energjisë elektrike, në mars të vitit 2014 Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë e Shqipërisë nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për themelimin e tregut të përbashkët energjetik Kosovë-Shqipëri. Që të dy shtetet po punojnë intenzivisht për ndërtimin e këtij tregu i cili vlerësohet të ketë përfitime të shumta për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe gjithashtu është një hap përpara drejt intergrimit në tregun rajonal të Evropës Juglindore. Për më tepër, në mars të vitit 2016 në prag të 10 vjetorit të themelimit të KOSTT, të dy qeveritë janë zotuar të bashkëpunojnë në krijimin dhe operimin e Bursës Shqiptare të Energjisë në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e

Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore.

KOSTT mbetet e përkushtuar për të implementuar zotimet në kuadër të procesit të Dialogut për Energji si dhe obligimet karshi Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore si dhe vazhdon me aktivitetet për përbushjen e "masave të buta" në kuadër të procesit Western Balkans 6 Energy Connectivity Initiative.

Në këtë periudhë 10 vjeçare të operimit, KOSTT ka përmbyllur me sukses procese të rëndësishme për të ardhmen e kompanisë dhe sektorit të energjisë në përgjithësi në Kosovë. Së fundi janë shënuar dy momente historike për kompaninë: pas 27 vitesh që kur u ndërtua linja e parë interkonektive me Shqipërinë, në dhjetor të vitit 2015 u shënuar përfundimi i punimeve deri në kufirin me Shqipërinë në linjën 400 kV që lidhë Nënstacionin Kosova B me Nënstacionin Tirana 2.

TANI MË SISTEMI TRANSMETUES I KOSOVËS DO TË JETË I LIDHUR ME NIVELIN 400 kV ME TË GJITHA SHTETET FQINJE, GJË E CILA E FORCON EDHE MË SHUMË POZITËN E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK TË KOSOVËS NË RAJON SI NJË NYJE E RËNDËSISHME E CILA MUNDËSON TRANZITIN DHE I KONTRIBUON SIGURISË DHE BESUESHMËRISË SË SISTEMIT RAJONAL ENERGJETIK.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në vitin 2015 për KOSTT ishte nënshkrimi i Marrëveshjes për Kycje me ENTSO-E i cili u mundësua pas verifikimeve dhe testimeve të hollësishme teknike që u bënë nga ana e ENTSO-E. Kjo marrëveshje kontraktuale, i mundëson KOSTT-it të bëhet zonë/blok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale si dhe, edhe në baza legale dhe komerciale të operoj sinkron me Sistemin Evropian të Transmetimit të energjisë elektrike. Marrëveshja ende nuk ka hy në fuqi, prandaj kjo është një nga çështjet kryesore me të cilat menaxhmenti i KOSTT po merret intenzivisht.

Paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar

dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi prej 1109.38 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë. KOSTT tashmë është i regjistruar në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve dhe aktualisht po shqyrton mundësitë e shfrytëzimit komercial të kapaciteteve të lira të fibrave optik.

KOSTT i ka konsideruar gjithnjë punonjësit e vet si një nga asetet më të rëndësishme, dhe si rezultat i kushton vëmendje të veçantë mirëqenies së tyre, shëndetit, kushteve të punës si dhe zhvillimit dhe avancimit të tyre profesional. KOSTT aktualisht numëron 349 punonjës prej të cilëve 115 janë me përgatitje superiore ndërsa 87 janë inxhinier.

NË VITIN 2010 KOSTT ISHTE KOMPANIA E PARË PUBLIKE E CILA U ÇERTIFIKUA ME STANDARDIN PËR MENAXHIMIN E CILËSISË ISO 9001:2008 NDËRSA AKTUALISHT PO PUNON INTENZIVISHT NË ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR TË MENAXHIMIT DUKE PËRFSHIRË EDHE STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË SIGURISË NË PUNË OHSAS 18001 SI DHE STANDARDIN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT ISO 14001.

Për më tepër KOSTT sh.a në mënyrë të vazhdueshme është e përkushtuar në implementimin e parimeve të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave si për nga aspekti i veprimtarisë që ushtron duke operuar në mënyrë të përgjegjshme dhe etike dhe në anën tjetër, duke përkrahur komunitetin bënë përpjekje për të ndikuar të zhvillim të qëndrueshëm. KOSTT gjithashtu është anëtare e Kosovo CSR Network - rrjeti i parë i bizneseve e themeluar me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut për CSR si dhe promovimin e përfshirjes së praktikave më të mira në kompanitë e tyre

KOSTT mbetet i përkushtuar në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergjetik dhe nga ky pozicion të jap kontributin në rritjen ekonomike dhe mirëqenien shoqërore të Kosovës.



VLERËSOHET PERFORMANSA SI DHE ROLI QENËSOR I KOSTT NË FUNKSIONIMIN E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në vizitën të cilën e realizuan me 20 korrik 2016 në KOSTT, Kryeministri i Kosovës z.Isa Mustafa dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci ku u pritën nga menxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani si dhe bordi i KOSTT në krye me Kryesuesen znj.Drita Konxheli-Radoniqi, u vlerësua lart performansa e kompanisë si dhe roli qenësor i KOSTT në funksionimin e gjithmbarshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës.

DUKE E VLERËSUAR ORGANIZIMIN DHE OPERIMIN SHUMË TË SUKSESSHËM TË KOSTT SI NË PIKËPAMJE TË DETYRAVE ASHTU DHE NË PIKËPAMJE FINANCIARE, KRYEMINISTRI MUSTAFA MË TUTJE THEKSOI "KA PASUR INVESTIME TË SUKSESHME NË PERIUHDËN E KALUAR, RRETH 200 MILIONË EURO, DHE PO ASHTU KA PAS NJË PLAN SHUMË KONKRET TË INVESTIMEVE PËR TË ARDHMEN".

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Hasani me këtë rast theksoi "Ne po punojmë edhe për investimet në

vazhdim, për të cilat shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe Bankën Botërore, USAID, Komisionin Evropian, Bankën Gjermane për Zhvillim, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që të gjitha këto kapacitete, kjo teknologji e avancuar dhe jashtëzakonisht bashkëkohore është në funksion të përditshëm të KOSTT".

Gjithashtu edhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci, vlerësoi rolin domethënës dhe të pazëvendësueshëm të KOSTT në kuptimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit që i jep sistemit elektroenergjetik të vendit tonë.

Në kuadër të vizitës, delegacioni qeveritar u njoftua për së afërmi nga menaxhmenti dhe bordi në lidhje me punën që po zhvillohet në KOSTT si në kuptimin e operimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit të Kosovës gjithashtu dhe për investimet në zhvillimin e modernizimin e tij. Gjithashtu, më tutje delegacioni qeveritar u njoftua për angazhimet në integrimet rajonale dhe evropiane të KOSTT dhe sfidat në kuadër të këtyre proceseve.



Me këtë rast Kryeministri Mustafa Koli për rëndësinë që ka linja e re 400 kV Kosovë-Shqipëri për sistemin elektroenergjetik, funksionalizimi i së cilës ka mbetur peng i mos-implementimit të marrëveshjes për energji nga ana e Serbisë dhe potencoi që Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të bëjë përpjekje maksimale që kjo marrëveshje të implementohet dhe që KOSTT të operojë në treg krahas fushave të tjera të cilat po i zhvillon në Kosovë, në mënyrë që të arrihet ushtrimi i sovranitetit të plotë në tërë

territorin e Republikës së Kosovës.

“Ju e dini që në muajin e kaluar në qershor dhe muaj më parë në dhjetor të vitit të kaluar kemi lansuar linjën e re interkonektive, pra “Autostradën Energjetike”, që është njëra nga kryeveprat më të mëdha kapitale që është bërë në Republikën e Kosovës por edhe në Republikën e Shqipërisë dhe presim që ky projekt të operacionalizohet me fillimin e funksionimit të KOSTT-it si një bllok i pavarur”, theksoi ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Stavileci.

KOSTT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME KEDS PËR SHFRYTËZIMIN E PRONAVE ME QËLLIM TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTEVE TË TRANSMISIONIT

Me 3 qershor 2016 në Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS z.George Karagutoff, nënshkruan marrëveshjen për shfrytëzimin e lokacioneve ekzistuese të nënstacioneve të KEDS për ndërtimin e aseteve të reja të transmisionit (stabilimentet GIS dhe transformoret energjetik 2x40 MVA me infrastrukturen tjetër përcjellëse), për projektet e KOSTT të bashkëfinancuara me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH): NS 220/10(20) kV- Drenasi 2, NS 110/10(20) kV -Prishtina 6, NS 110/10(20) kV - Mitrovica 2 dhe NS 110/10(20) kV- Fushë Kosova.



Ky është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm drejt nënshkrimit të Marrëveshjeve për Këqje në Rrjetin Transmetues në mes të KEDS dhe KOSTT për objektet e lartpërmendura, si dhe fillimit të realizimit të këtyre projekteve të KOSTT që kanë për qëllim furnizimin më cilësor të konsumatorëve me energji elektrike në këto qytete.

KOSOVA DHE SHQIPËRIA TË VENDOSURA PËR KRIJIMIN E TREGUT TË PËRBASHKËT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Pas takimit të Komitetit Drejtues për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri, në ambientet e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës në Tiranë, Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Blerand Stavileci dhe Ministri i Industrisë dhe Energjetikës së Shqipërisë z.Damjan Gjijnuri më 30 mars 2016 firmosën një deklaratë të përbashkët përmes së cilës morën një sërë angazhimesh në kuadër të nismës për ndërtimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike.



Përmes kësaj deklarate, përcaktohet që Grupet e Punës, nën koordinimin e Komitetit Drejtues, do të punojnë së bashku në identifikimin dhe përcaktimin e fazave të mëtejshme dhe afateve përkatëse në drejtim të integritimit të plotë të tregut të energjisë elektrike sipas një udhërrëfyese të dakorduar në mes të palëve, të mbështetura nga një asistencë e përbashkët teknike.

Me këtë rast, Ministri Stavileci theksoi që Qeveritë e dy vendeve kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta, ndërkohë që ka vazhduar puna e ekspertëve të nivelit teknik, në shumë aktivitete dhe projekte të përbashkëta.

Në anën tjetër Ministri Gjijnuri ka theksuar që "Shqipëria dhe Kosova kanë mëse dy vjet që po punojnë në mënyrë intensive për këtë proces. Puna është e vazhdueshme në terren, me përfundimin e linjës së interkonjeksionit, një vepër jashtëzakonisht e rëndësishme energjetike e cila do të inaugurohet në Qershor dhe fillon të bëhet funksionale. Pra, fizikisht të dyja vendet tashmë janë të lidhura me rrjetin energjetik të përbashkët. Nga ana tjetër, këto investime po pasohen dhe me politika të përbashkëta për krijimin e këtij tregu."

Përveq tjerash, me Deklaratën e Ministrave të datës 30 mars 2016 përcaktohet që KOSTT dhe OST Shqipëri do të bashkëpunojnë në krijimin dhe operimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APE) në përputhje me

Direktivat e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (SKE), si dhe do të lehtësojnë integrimin e Bursës Shqiptare të Energjisë me Bursat e Energjisë në vendet fqinje duke i vënë në dispozicion kapacitetet e interkoneksionit. Palët do të bashkëpunojnë në krijimin e një zone të vetme tregtare si dhe do të punojnë për të optimizuar kapacitetet transmetuese. Ndryshe një ditë më herët, me 29 mars 2016 në Tiranë, u zhvillua takimi në mes të homologëve të institucioneve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë, ku ishte prezent Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani. Në kuadër të takimit, përfaqësuesit e të dyja palëve prezantuan zhvillimet e fundit që ndërlidhen me krijimin e



tregut të përbashkët të energjisë. Me këtë rast, z.Hasani prezantoi zhvillimet aktuale në Sistemin e Transmisionit në Kosovë si dhe foli për proceset aktuale të integrimi rajonale dhe evropiane me të cilat aktualisht po merret KOSTT. Z.Hasani në veçanti theksoi që "KOSTT do të vazhdojë që në mënyrë proaktive të punoj në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe në ngritjen e kapaciteteve të transmisionit duke kontribuar kështu në krijimin e kushteve për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe ngritjen e besueshmerisë së Sistemit të Transmisionit".

U PREZANTUA RAPORTI I VLERESIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PROJEKTIN E LINJËS SË DYFISHTË 110kV QË LIDHË NS 400/110kV PEJA 3 ME NS 110/35/10 kV PEJA 1

Nën organizimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës KOSTT sh.a, me 12 Prill 2016 u mbajt Debat Publik ku u prezantua Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin e Linjes së dyfishtë 110 kV që lidhë NS 400/110kV Peja 3 me NS 110/35/10 kV Peja 1.

Raporti i VNM-së ka për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike si dhe ofron rekomandime në lidhje me implementimin e projektit nga ky aspekt. Sipas analizave të realizuara në kuadër të raportit për VNM, implementimi i projektit të linjës së dyfishtë 110 kV që lidhë NS 400/110kV Peja 3 me NS 110/35/10 kV Peja 1 është paraparë të bëhet me rregulla të pranueshme dhe në distanca të pranueshme nga shtëpitë dhe rruga. Raporti gjithashtu arsyeton planet për vendosjen e kabllave nëntokësore për një gjatësi prej afro 1.6 km në afërsi të Nënstacionit Peja 1, me qëllim të mënjanimit të ndikimit të madh social dhe



mjedisor momental që ka linja ekzistuese. Gjatë këtij debati ekspertet e fushës së energjetikës të KOSTT sh.a, folën para të pranishmëve mbi rëndësinë që ka realizimi i këtij projekti për sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit për rajonin e Pejës dhe Istogut. Ndërtimi i linjës së dyfishtë 110 kV që lidhë NS 400/110kV Peja 3 me NS 110/35/10 kV Peja 1 është pjesë e projektit "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit - Programet sektoriale IV dhe V". Projekti planifikohet të fillojë në fillim të muajit Qershor dhe kohëzgjatja e planifikuar e projektit është 24 muaj.

DELEGACIONI I KOSTT NË KRYE ME KRYETAREN E BORDIT TË DREJTORËVE MERR PJESË NË FORUMIN E VJENËS PËR ENERGJI

Nën organizimin e përbashkët të Sekretariatit të Komunitetit për Energji dhe Florence School of Regulation, u mbajt Forumi i Vjenës për Energji i cili mbledhi mbi 100 ekspertë nga kompanitë energjetike, rregullatorët e energjisë, qeveritë, akademia dhe institucione të tjera të fushës nga vende të ndryshme të Evropës.

Në këtë Forum dy ditë i cili u mbajt me 14 dhe 15 prill 2016, mori pjesë edhe një delegacion nga KOSTT i kryesuar nga Kryetarja e Bordit të Drejtorëve znj. Drita Konxheli-Radoniqi.

Qëllimi i Forumit të Energjisë ishte diskutimi rreth çështjeve aktuale të sektorit të energjisë sidomos në



vendet e Evropës Juglindore me theks në çështjet ligjore që ndërlidhen me politikën e BE-së për energji, si dhe integrimi në tregun e brendshëm të energjisë të Bashkimit Evropian

KRYESHEFI EKZEKUTIV I KOSTT Z.HASANI MERR PJESË NË FORUMIN E NIVELIT TË LARTË "SIGURIA E FURNIZIMIT ME ENERGIJE ELEKTRIKE NË KOSOVË"

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë mori pjesë në Forumin e Nivelit të Lartë "Siguria e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë", organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe përkrahur nga projekti REPOWER (USAID).

Në Forum morën pjesë përfaqësues të lartë të Qeverisë së Kosovës përfshirë Kryeministrin z.Isa Mustafa, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci, Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor z.Ferid Agani, Ambasadorin e SHBA në Kosovë z.Greg Delawie, Drejtorin e Zyrës së Bankës Botërore për Kosovë z.Marco Mantovanelli dhe përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë. Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e komunitetit të industrisë, organizatave jo-qeveritare, akademisë, biznesit dhe mediave.

Me këtë rast z.Hasani prezantoi para audiencës rolin e KOSTT në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës, gjendjen aktuale të Rrjetit të Transmisionit, rëndësinë e zhvillimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe zhvillimeve të fundit në raport me rrjetin evropian të OST-ve (ENTSO-E).

Të pranishmit patën rastin gjithashtu të njoftohen me përfitimet nga investimet e vazhdueshme që janë bërë në rrjet që kanë rezultuar me rritjen e kapaciteteve të brendshme transmetuese; kapaciteteve interkonektive; rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit; zvogëlimin e humbjeve në transmision; rëndësinë e zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, si dhe rritjen e performancës së sistemit në përputhje me kërkesat teknike të ENTSO-E.

Në Forum, është diskutuar edhe për përparësitë që sjell tregu i përbashkët i energjisë elektrike me Shqipërinë në raport me stabilitetin e furnizimit dhe operimit të Sistemit Elektroenergjetik gjë e cila përveq tjerash vlerësohet të ketë ndikim edhe në uljen e çmimeve të energjisë elektrike.



Pjesëmarrësit në Forum kanë folur gjithashtu edhe për performancën pozitive të KOSTT me ç'rast ndër të tjera nga përfaqësuesit institucional është përhëndetur avansimi i theksuar që është arritur ndër vite në zvogëlimin e nivelit të humbjeve në transmision i cili është nën nivelin e lejuar nga ZRRë gjë e cila e bën të jetë kompania transmetuese me humbjet më të ulta në rajon.



Në panelin për diskutime ku KOSTT u përfaqësua nga z.Kadri Kadriu zv.Kryeshef ndër të tjera u potencua që kapacitetet e rrjetit transmetues të Kosovës mundësojnë kycjen e kapaciteteve të reja gjeneruese përfshirë edhe burimet e renovueshme të energjisë elektrike.

NËNSHKRUHEN KONTRATAT PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I SISTEMIT TRANSMETUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS", BASHKËFINANCUAR ME BERZH



Më 20 Qershor 2016, KOSTT nënshkroi kontratat për implementimin e disa projekteve të bashkëfinancuara me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës.

Projektet për Zhvillimin e Sistemit Transmetues përbëhen nga tri LOT-e:

LOT 1-Nënstacionet GIS: parasheh ndërtimin e tre nënstationeve të tensionit të lartë 110 kV dhe 220 kV: NS 110/10(20) kV – Prishtina 6, NS 110/10(20) kV – Mitrovica 2, NS 220/10(20) kV – Drenasi 2, zgjerimin e NS Prishtina 4 me dy fusha kabllorike 110 kV si dhe rindërtimin e NS 110/35/10 kV – Theranda, që do të implementohen nga konzorciumi ABB Itali dhe ABB Kroaci;

LOT2-Transformatorët Energjetik: parasheh furnizimin dhe instalimin e gjashtë transformatorëve energjetik, 2x40 MVA në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Drenasi 2, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2, që do të implementohet nga konzorciumi Hyundai Heavy Industries Co. (Bullgari) dhe Balkan Petrol Energy (Kosovë);

LOT 3-Largpërçuesit dhe kabllot transmetuese: parasheh ndërtimin e 19 km largpërçues të tensionit të lartë 110 kV dhe sistemin e kabllorëve nëntokësorë 110 kV për furnizimin e nënstationeve të lartshënuara, përfshirë edhe largpërçuesin e ri 110 kV (rreth 16.5 km), drejtimi NS Rahovec – NS Therandë si dhe ndërtimin e 3.4 km largpërçues të tensionit të lartë 220 kV, që do të implementohet nga Romelectro (Rumani).

Në kuadër të këtij investimi gjithashtu përfshihet edhe kontrata për Shërbime Konsulente për mbikëqyrjen e punëve implementuese, e cila do të implementohet nga AF-Consult (Zvicër/Maqedoni) si dhe kontrata për Ngritje të Kapaciteteve, që do të implementohet nga Elia (Belgjikë).

INVESTIMI NË IMPLEMENTIMIN E KËTYRE PROJEKTEVE MUNDËSOHET PËRMES KREDISË KOMERCIALE AFATGJATE, QË KOSTT SH.A E KA SIGURUAR NGA BERZH NË VLERË PREJ € 30 MILION, € 4.5 MILION NGA BUXHETI I KOSTT PËR INVESTIME KAPITALE SI DHE GRANTI NGA BERZH NË VLERË PREJ € 2 MILION.

Këto projekte të përkrahjes së konsumit, do të ndikojnë në ngritjen e furnizimit me stabil dhe më cilësor të konsumatorëve me energji elektrike në Rajonin e Prishtinës, Drenasit dhe Mitrovicës. Për më tepër, KOSTT do të përmbushë një nga kriteret kyçe të sigurisë së rrjetit transmetues, për anëtarësimin në Asociacionin e Operatorëve Evropian të Energjisë Elektrike (ENTSO-E), i cili promovon integrimin e tregut dhe transparencën në transmetimin e energjisë elektrike.

Me rastin e nënshkrimit të kontratave, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani duke e falënderuar BERZH-in, ndër të tjera theksoi "Unë besoj që ky partneritet që kemi ndërtuar me BERZH do të forcohet edhe më tutje dhe do të dëshmojë përkushtimin tonë për të kontribuar në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë", kurse znj. Elena Petrovska, Udhëheqëse e Zyrës së BERZH-it në Kosovë ndër të tjera theksoi se "është e kënaqur me përfundimin e suksesshëm të kësaj faze dhe uroi implementim të suksesshëm të projektit, investim i cili njëherit përbën kredinë e parë të BERZH pa garancion shtetëror për një ndërmarrje publike në Kosovë"

Nga momenti i fillimit të punimeve, implementimi i projekteve parashihet që të përfundojë në afat prej 24 muajsh.



INAUGUROHET LINJA INTERKONEKTIVE 400 kV KOSOVË-SHQIPËRI

Pas 28 vitesh që kur u ndërtua linja e parë dhe e vetme interkonektive gjer më tani në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, me 28 qershor 2016 në Nënstacionin Tirana 2, në praninë e delegacioneve të larta të Qeverive të të dyja vendeve u inaugurua linja ndërshtetërore 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri ka një gjatësi totale prej 241.1 km, nga të cilat 151.1 km shtrihen në territorin e Shqipërisë dhe 90 km shtrihen në territorin e Kosovës. Punimet për ndërtimin e linjës në pjesën e Kosovës kanë përfunduar në dhjetor 2015, ndërsa në pjesën e Shqipërisë në qershor 2016.

Në fjalën e tij të rastit, Kryeministri i Kosovës z.Isa Mustafa theksoi se “energjia është shtyllë tepër e rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, parakusht i rritjes së investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme, si dhe parakusht i mirëqenies së qytetarëve. Ndërsa Kryeministri i Shqipërisë z.Edi Rama me këtë rast theksoi “Inaugurimi i kësaj linje është nisja e një kapitulli të ri për integrimin e të dy vendeve. Sot shohim me krenari sa shumë kemi bërë për t’u afruar dhe për t’i dhënë hapësirës tonë të përbashkët fuqi dhe potenciale zhvillimi, përmes një integrimi të gjithanshëm, duke filluar nga energjia e duke vazhduar në të gjithë sektorët”.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, tha

se integrimin ekonomik të të dy vendeve tona që po bëhet gjithnjë e më real dhe më i prekshëm, e tregon edhe projekti i sotëm i autostradës energjetike, e cila është në linjë me politikat e Bashkimit Evropian dhe në pajtueshmëri me iniciativën e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6).

Financimi i projektit për pjesën e Kosovës është bërë nga Qeveria Gjermane bazuar në Marrëveshjen e Financimit që është nënshkruar në mes të KfW, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (Qeveria e Kosovës) dhe KOSTT, për hua dhe kontribut financiar në vlerën e përgjithshme prej 33.5 milion Euro, nga e cila €16.5 milion grant dhe €17 milion kredi. Ngjashëm, Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW gjithashtu ka financuar pjesën e linjës në anën e Republikës së Shqipërisë.

Linja interkonektive e tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri përveq ndikimit që do e ketë në ngritjen e kapaciteteve transmetuese në me të dy vendeve si dhe ngritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së Sistemit Elektroenergjetik të të dy vendeve, gjithashtu do



të ketë ndikim në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike në mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe do të ofroj kapacitete të mjaftueshme transmetuese në Bursën e energjisë në Shqipëri PX (Power exchange) për të cilën Kosova ka shprehë gadishmërinë dhe vullnetin të jetë bashkë themeluese dhe pjesëmarrëse. Në ceremoni morën pjesë Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Isa Mustafa, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë z. Edi Rama, zëvendëskryeministri i

parë i Kosovës, z. Hajredin Kuçi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Blerand Stavileci dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë z. Damian Gjoknuri, Ministria për Dialog z. Edita Tahiri, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe Administratori i përgjithshëm z. Engjëll Zeqo, përfaqësues nga KfW (Gjermani) dhe përfaqësues të tjerë të lartë shtetëror dhe të institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare.

MENAXHMENTI I KOSTT PRITI NË VIZITË DELEGACIONIN E LARTË NGA OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË SHQIPËRISË

Menaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Mustafë Hasani, pritën në vizitë delegacionin e lartë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Shqipërisë në krye me z. Engjëll Zeqo, administrator i përgjithshëm. Në takim, u diskutua për çështje me interes për Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës dhe Shqipërisë në përgjegjësi të dy kompanive homologe, ku si tema të veçanta ishin bashkëpunimi në proceset e integriteteve regjionale dhe evropiane si dhe hapat e mëtejshëm në kuadër të krijimit të tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri. Me këtë rast z. Hasani dhe Zeqo gjithashtu u shprehën të përkushtuar në bashkëpunimin e mëtejshëm që Kosova (KOSTT) të jetë pjesë e brezës së energjisë (Power Exchange) që është duke u krijuar në Shqipëri si dhe u diskutua për modalitetet e operacionalizimit të linjës ndërshtetërore 400 kV Kosovë Shqipëri, punimet e së cilës në anën e Shqipërisë pritet të finalizohen brenda muajit qershor 2016.

Në kuadër të zotimit për thellimin e bashkëpunimit, me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe Administratori i Përgjithshëm i OST



z. Engjëll Zeqo nënshkruan disa dokumente në mbështetje të bashkëpunimit në proceset e integriteteve regjionale dhe evropiane.

Të dy homologët u shprehën të kënaqur me takimin dhe shprehën gatishmërinë për thellimin e marrëdhënieve në çështje me interes të dyanshëm dhe shprehën interesimin për vazhdimin e bashkëpunimit në shkëmbim të përvojave në mes të dy kompanive.

AMBASADORI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KOSOVË Z. QEMAL MINXHOZI VIZITOI KOSTT-in



Në dritë të inaugurimit të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri në muajin qershor 2016 në Tiranë pas përfundimit të punimeve në pjesën e Shqipërisë, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani priti në takim Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi.

Në takim u bisedua rreth bashkëpunimit aktual si dhe mundësitë e thellimit të mëturjes së bashkëpunimit Kosovë-Shqipëri në fushën e transmetimit të energjisë elektrike, zhvillimet në drejtim të tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri si dhe bashkëpunimit në proceset e integritimeve rajonale dhe evropiane.

Ndër të tjera, z. Hasani shprehu falënderimin e tij për gatishmërinë e përhershme të institucioneve

të Republikës së Shqipërisë e në veçanti kompanisë homologe (OST Shqipëri) për bashkëpunimin e vazhdueshëm në avancimin e projekteve të përbashkëta dhe proceset e integritimeve rajonale dhe evropiane të KOSTT.

Në anën tjetër, Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi theksoi gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Shqipërisë për avancimin e bashkëpunimit me theks në fushën e energjisë elektrike i cili aktualisht përbën sektorin me bashkëpunimin më të madh ndërshtetëror.

Me këtë rast Ambasadori Minxhozi vizitoi edhe Qendrën Nacionale Dispečerike në KOSTT, e cila është një nga Qendrat më të avancuara e cila operon në përputhje me normat më të larta teknike Evropiane.

MENAXHMENTI I KOSTT I PËRKUSHTUAR NË PËRMBUSHJEN E PLANEVE ZHVILLIMORE TË RRJETIT TRANSMETUES

Në kuadër të angazhimeve për përmbushjen e planeve zhvillimore të KOSTT, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë, gjatë muajit korrik 2016 realizoi disa vizita në terren për inspektimin e punimeve që po zhvillohen në kuadër të projekteve zhvillimore.

Gjatë vizitave të ndara që u realizuan në NS 110/10 kV Prishtina 2, në kuadër të implementimit të projektit "Furnizimi dhe Instalimi i transformatorit TR3 40MVA në NS. 110/10kV Prishtina 2", si dhe punimeve në kuadër të implementimit të projektit "Rehabilitimi i stabilimenteve të tensionit të lartë në NS 110/10 kV Prizreni 3 dhe NS 110/10 Gjakova 2" u konstatua edhe një herë që këto projekte kapitale do të kenë ndikim të theksuar në ngritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i



transmisionit, plotësimin e kriterit N-1 si dhe ngritjen e performancës operuese të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht kualitetit të furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike.

KOSTT edhe më tutje mbetet e përkushtuar në përmirësimin e kualitetit të shërbimeve dhe ngritjes së sigurisë në furnizim me energji elektrike për të gjithë qytetarët.

MENAXHMENTI I KOSTT INSPEKTOI PUNIMET QË PO ZHVILLOHEN NË KUADËR TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I RRJETIT TRANSMETUES”, FAZA IV DHE V


Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë, në mujin gusht inspektuan nga afër punimet që po zhvillohen për ndërrimin e ndërprerësve të fuqisë 220 kV dhe 110 kV në Nënstacionin Prishtina 4. Ky projekt është pjesë e LOT 1: “Nënstacionet” të Projektit “Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit” i cili parashihet implementimin e 10 projekteve që mundësohen përmes kredisë komerciale afatgjate që KOSTT sh.a e ka siguruar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) me kushte kredituese të buta në vlerë prej €23,5 milion nga e cila €15,5 milion me periudhë kthyesë prej 15 viteve dhe €8 milion me periudhë kthyesë prej 40 viteve, si dhe financimin shtesë në formë granti nga Komisioni Evropian në vlerë prej €7.35 milion përmes programit IPA. Implementimi i projekteve në fjalë, që njëherit janë pjesë e Planit Zhvillimor të Transmisionit do të kenë



ndikim të theksuar në sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit, rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese të energjisë elektrike, plotësimin e kriterit N-1 dhe ngritjen e performancës operuese të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës. LOT 1-Nënstacionet është duke u implementuar nga kontraktuesi SIEMENS (Austri).

TË DHËNAT E TRANSPARENCËS

Parashikimi dhe realizimi i ngarkesës dhe gjenerimit



Sipas obligimeve nga Rregullorja e Bashkimit Evropian (BE) nr.543/2013, KOSTT në muajin korrik 2016 ka filluar publikimin në webfaqe të “Të dhënave të Transparencës” që përfshijnë të dhënat për parashikimin dhe realizimin në kohë reale të ngarkesës dhe gjenerimit në Sistemin Transmetues

të Republikës së Kosovës si dhe planifikimi i shkyçjeve. Për herë të parë në Kosovë këto të dhëna janë publike dhe të gjithë të interesuarit mund ti gjejnë në ballinën e webfaqes së KOSTT www.kostt.com me titull: Ngarkesa dhe Gjenerimi në Sistemin Transmetues.

KUVENDI I KOSOVËS MIRATON LIGJET E REJA TË ENERGJISË

Për të garantuar furnizim të sigurtë të konsumatorëve me energji elektrike dhe me qëllim të organizimit të sektorit të energjisë në përputhje me kërkesat e Pakos së Tretë të energjisë të Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës në muajin qershor 2016 ka miratuar, ndërsa në muajin korrik janë shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës tri ligjet e reja të sektorit të energjisë:

- **Ligji për Energjinë (nr.05/L-081)** - Fushëveprimi i këtij ligji përfshin përcaktimin e kornizës rregullative për zhvillimin e politikave dhe strategjive, rolin e akterëve në zbatimin e tyre për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas me energji. Ky ligj përfshin energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror dhe energjinë nga burimet e ripërtërishme

- **Ligji për Energjinë Elektrike (nr.05/ L-085)** - Fushëveprimi i këtij ligji përfshin rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të



drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës dhe

- **Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (nr.05-L-084)** - që rregullon kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji

Nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjeve paraprake (për Energjinë, Energjinë Elektrike dhe Rregullatorin e Energjisë) duhet të harmonizohen me këto ligje.

Ligjet e reja të energjisë mund të shkarkohen nga webfaqja e Kuvendit të Kosovës www.kuvendikosoves.org apo në webfaqen e KOSTT www.kostt.com

VENDIMET E ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË (GJATË PERIUDHËS SHKURT-GUSHT 2016)

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 23 qershor 2017, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamenti i dokumentit "Kodi i Punës për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa" të KOSTT sh.a. (V_834_2016)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 23 qershor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të i lejohet KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (V_833_2016)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit

të mbajtur me 31 mars 2016, në bazë të aplikacionit të KOSTT, bazuar në dispozitat relevante ligjore ka marrë vendim për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a, përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifar SHTE10 (V_798_2016)

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 31 mars 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a. (V_802_2016)